



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/146 Nr. ifaq/Bratr/No.pg 08

Data/Datum/Date 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 4.4, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.5.2025, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit *ad-hoc* për shqyrtimin e ankesave

1. Caktohet komisioni *ad-hoc* për shqyrtimin e ankesave të parashtruara nga kandidatët që kanë aplikuar për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe, në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve si në vijim:
 - 1.1. Saranda Sallteku, anëtare;
 - 1.2. Qazim Cana, anëtar;
 - 1.3. Behlul Krasniqi, anëtar.
2. Komisioni i caktuar në pikën 1 të këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar në thirrjen publike për anëtar të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe dhe pas kësaj, të marrë vendim për miratimin apo për refuzimin e ankesave.
3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Anëtarëve të Komisionit
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.146/26
Më datë:29.05.2026



Fatmir Iska

Kryesues i Kuvendit